

## V E N D I M

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga :

|                          |                 |
|--------------------------|-----------------|
| <b>Xhezair Zaganjori</b> | <b>Kryesues</b> |
| <b>Arjana Fullani</b>    | <b>Anëtar</b>   |
| <b>Evelina Qirjako</b>   | <b>Anëtar</b>   |
| <b>Medi Bici</b>         | <b>Anëtar</b>   |
| <b>Tom Ndreca</b>        | <b>Anëtar</b>   |

me sekretare gjyqësore **Dorina Dulaj**, në Tiranë, sot më datë 03.05.2017, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, çështjen administrative që i përket:

**PADITËS:** **Drita Dalipaj (në mungesë);**

**E PADITUR:** **Ministria e Mjedisit (në mungesë);**

**OBJEKTI:** *Shfuqizimin e aktit administrativ, shkresës nr. 2106, datë 21.02.2014 “Propozim për kalim në listë pritje të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, si akt absolutisht i pavlefshëm; Deklarimin e pavlefshëm të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës mes paditëses dhe palës së paditur dhe kthimin në punë në detyrën e mëparshme; Detyrimin e palës së paditur për të paguar shpërblimin financiar (pagën e plotë), që nga momenti i ndërprerjes së padrejtë të marrëdhënieve financiare, me date 01.04.2014, që nënkupton momentin e rikthimit në detyrën e mëparshme;*

**BAZA LIGJORE:** *Ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil”, neni 324 e vijues i Kodit të Procedurës Civile, Ligji Nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.*

**Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr. 4710, datë 12.09.2014, ka vendosur:

- *Konstatimin e pavlefshëm të aktit administrativ, shkresës nr. 2106, datë 21.02.2014 “Propozim për kalim në listë pritje”, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit si akt absolutisht i pavlefshëm.*

- *Detyrimin e palës së paditur për të paguar shpërblimin financiar (pagën e plotë), që nga momenti i ndërprerjes së padrejtë të marrëdhënieve financiare, me datë 01.04.2014, deri në datën e ekzekutimit të vendimit, që nënkupton momentin e rikthimit në punën e mëparshme.*

**Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 719, datë 09.04.2015, ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. 4710, datë 12.09.2014.*

**Kundër vendimit nr. 719, datë 09.04.2015**, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka bërë rekurs pala e paditur, Ministria e Mjedisit, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi si dhe të vendimit nr. 4710, datë 12.09.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe pushimin e gjykimit të çështjes

\*\*\*

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 63, shkronja “e”, të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;

#### **V E N D O S I:**

Lënien në fuqi të vendimit nr. 719, datë 09.04.2015, të Gjykatës së Apelit Administrativ.

**Tiranë, më 03.05.2017**

**Nr. 31001-01475-00-2015 i Regj. Themeltar  
Nr. 00-2017-920 i Vendimit (334)**